



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI  
KOMISIONERI

Nr. 41/6 Prot.

Tiranë, më 09.06.2026

**V E N D I M**

**Nr. 162, Datë 09.06.2026**

Bazuar në nenet 32 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është regjistruar ankesa me nr. 7, datë 06.01.2026, e paraqitur nga z. A.M kundër Ministrisë së Arsimit, Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, pranë Bashkisë Korçë dhe Drejtorit të Shkollës 9-vjeçare “Nuçi Naçi”, në të cilën pretendon diskriminimin e fëmijëve të mitur N.M dhe E.M, për shkak të “aftësisë së kufizuar<sup>1</sup>”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues informon se: “Jam babai i dy fëmijëve nxënës të shkollës 9-vjeçare “Nuçi Naçi” Korçë, përkatësisht në klasën e tretë dhe të gjashtë. Shqetësimi i ngritur pranë institucionit tuaj ka lidhje me mospërfitimin e bursës në bazë të VKM nr. 666, datë 10.10.2019, pika 2.3/d.

Në muajin tetor bashkëshortja ime si çdo vit ka përgatitur dokumentacionin e duhur për bursë dhe në datën 5 të këtij muaji i ka çuar pranë drejtorisë së shkollës, më saktë ia ka çuar drejtorit të shkollës, i cili me një gjuhë tepër fyese dhe diskriminuese nuk ia ka mbajtur ato, por e ka larguar atë nga zyra duke i thënë që do i sillni në një moment tjetër, edhe pse lajmërimi nga institucioni përgjegjës pranë Bashkisë kishte dalë dhe dërguar me e-mail zyrtar dhe ai nuk po e zbatonte. Nga

<sup>1</sup> Referuar Vërtetimit datë 17.09.2025, të lëshuar nga Drejtoria e Kujdesit Social e Bashkisë Korçë, vërtetohet se D.M, nëna e fëmijëve, trajtohet me pagesë paaftësie me nr. dosje 1086.

ana jonë, dokumentet janë dorëzuar në datën 17 tetor, por në datën 20 tetor lajmërohem i të gjithë prindërit e shkollës që të plotësojmë të gjitha kriteret për të firmosur procesverbalin.

Në muajin dhjetor dalin emrat përfitues dhe çuditërisht nga kjo shkollë nuk ka asnjë fëmijë që të jetë përfitues, edhe pse i plotësojnë kriteret e përcaktuara në VKM.

Fëmijët e mijë kanë qenë përfitues të kësaj VKM-je prej 3 vitesh me të njëjtin dokumentacion dhe çuditërisht sivjet jo. Interesohem pranë Drejtorisë Mbështetëse të Bashkisë për të pyetur në lidhje me bursat, pasi nga shkolla nuk kemi patur asnjë lloj informacioni nëse ishim apo jo përfitues deri në datën e mbylljes së semestrit të parë, dhe specialistja pranë kësaj drejtorie më informon që të gjithë fëmijët e kësaj shkolle nuk janë përfitues, pasi janë penalizuar nga data e dorëzimit të dokumentacionit edhe pse ka qenë brenda afatit. Problematika më e madhe qëndron me drejtuesin e shkollës i cili edhe sot kur kam shkuar në shkollë që të flas me të, nuk ka pranuar, por na ka dërguar tek Bashkia duke na ofenduar”.

Ankuesi ka kërkuar nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit dhe përfitimin e bursës për dy fëmijët..

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri**

Sa më sipër, ankesa u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekzistonte asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” të ndryshuar. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenin 33 të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 41/1, datë 15.01.2026, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga subjektet, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.

Me shkresën nr. 40, datë 19.01.2026, Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, pranë Bashkisë Korçë në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “Z. A.M ka kërkuar bursë për fëmijët e tij, N.M dhe E.M, nxënës në shkollën “Nuçi Naçi”.

Sipas informacionit nga Drejtoria e shkollës, prindi ka dorëzuar dokumentet për të aplikuar për bursë pranë shkollës, nga shkolla janë pranuar dokumentet dhe së bashku me dokumentet e aplikuesve të tjerë i ka dorëzuar pranë Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes. Nga ana jonë dokumentacioni i dorëzuar është pranuar dhe shqyrtuar së bashku me të gjitha dokumentet e tjera të të gjithë nxënësve që kanë aplikuar për bursë.

Të dy nxënësit nuk kanë qenë përfitues të bursës për vitin shkollor 2025-2026 për shkak se numri i bursave të akorduara nga Ministria e Arsimit ka qenë shumë i ulët në krahasim me numrin e aplikuesve. Duke ndjekur me përpikëri procedurën e miratuar me VKB-në nr. 86, datë 29.08.2025, pika 3/h ku thuhet shprehimisht se: “Në rast se numri i përfituesve, sipas listës së sipërpërmendur, është më i lartë se numri i bursave të akorduara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, do të përfitojnë bursë ata nxënës që kanë dorëzuar më parë aplikimin pranë shkollës”, numri i kuotave

të bursave u plotësua me aplikantët që kishin dorëzuar dokumentacionin e plotë dhe të rregullt deri në datën 17.10.2025.

Duke qenë se ankuesja ka dorëzuar dokumentet për bursë në datën 20.10.2025, bazuar kjo në procesverbalin e aplikimit, i cili është i firmosur dhe nga prindi, nxënësit nuk kanë qenë përfytyrës të bursës për vitin shkollor 2025-2026.

Në lidhje me pjesën nëse nxënësit kanë përfytyruar apo jo bursë vitin e kaluar, sqarojmë se të dy nxënësit kanë qenë përfytyrës të bursave për vitin shkollor 2024-2025.

Për vitin shkollor 2025-2026, për shkak se nga Ministria e Arsimit, shkresa për planifikimin e numrit të bursave nuk erdhi në muajin Shtator, si vitet e tjera, procedura e njoftimit filloi në datën 06.10.2025. Njoftimi i shkollave u bë nëpërmjet email-it dhe njëkohësisht u publikua dhe në faqen zyrtare të Bashkisë Korçë. Modelet e procesverbaleve u hartuan nga ana jonë bazuar në dokumentacionin e miratuar me VKB-në nr. 86, datë 29.08.2025 dhe ju dërguan të gatshme drejtorive të shkollave dhe u udhëzuan që ti plotësonin në momentin që prindërit të dorëzonin dokumentet si dhe një kopje të firmosur nga të dyja palët t'ia jepnin prindërve. Shkresa për planifikimin e bursave nga Ministria e Arsimit ka ardhur në datën 21.10.2025. Në këtë shkresë Ministria kërkonte nga ana jonë numrin e aplikimeve brenda datës 27.12.2025. Me shkresën nr. 884, datë 27.10.2025 kemi kthyer përgjigje dhe kemi dërguar numrin e aplikantëve. Duke qenë se afati për dorëzimin e dokumenteve filloi me vonesë ne kemi marrë dokumentacion deri në datën 31.10.2025, dhe deri në këtë datë kanë qenë 703 aplikime gjithsej.

Nga Ministria e Arsimit për vitin shkollor 2025-2026 numri i bursave të miratuara ka qenë 280 bursa, 70 bursa më pak nga viti i kaluar. Nga fondet e Bashkisë janë akorduar 40 bursa, maksimumi që mund të jepej bazuar në buxhetin e Bashkisë. Në total për vitin shkollor 2025-2026 kemi pasur 320 bursa.

Duke parë që numri i aplikantëve, me dokumentacion të rregullt dhe brenda afateve, është shumë më i lartë se numri i bursave (542 aplikime të rregullta) nga ana jonë bazuar në vendimin e Këshillit Bashkiak janë përzgjedhur 320 aplikimet e para që janë dorëzuar pranë shkollave duke u mbështetur në datat e procesverbaleve të aplikantëve. Për pjesën tjetër të nxënësve të cilët janë me dokumentacion të rregullt, konkretisht 222 nxënës, i jemi drejtuar me shkresën nr. 993, datë 03.12.2025 Ministrisë së Arsimit për mbulimin me kuota për bursa për këta nxënës të cilët nuk përfytyruan. Nga Ministria na ka ardhur shkresa nr.7802/1, datë 15.12.2025, ku thuhet që Ministria e ka bërë shpërndarjen e bursave, duke lënë të kuptohet që nuk do të ketë më fonde për bursa. Ju sqarojmë se këto problematika janë shkaktuar nga mungesa e fondeve të transferuara nga ministria përkatëse, pasi nuk arrin të mbulojë kërkesat e të gjithë aplikantëve për bursë”.

Me shkresën nr. 36, datë 22.01.2026, Shkolla 9-vjeçare “Nuçi Naçi”, Korçë në mes të tjerash informoi Komisionerin se:

“1. Mbi respektimin e plotë të procedurës ligjore nga ana e shkollës.

*Shkolla 9-vjeçare “Nuçi Naçi” ka zbatuar në mënyrë të plotë dhe të rregullt procedurën për përfitim të bursave për vitin shkollor 2025-2026, në përputhje me VKM nr. 666, datë 10.10.2019, si dhe aktet nënligjore dhe udhëzimet përkatëse në fuqi.*

*2. Mbi dorëzimin brenda afatit të listës së nxënësve përfitues.*

*Lista me emrat e nxënësve që plotësonin kriteret për përfitim të bursës është hartuar, nënshkruar, protokolluar dhe dorëzuar brenda afatit të përcaktuar, konkretisht me datë 05.11.2026, pranë institucionit përgjegjës. Ky fakt provohet nga dokumentacioni shoqërues (email-et shoqëruese në datën përkatëse).*

*3. Mbi refuzimin e padrejtë dhe të pambështetur ligjërisht të listës.*

*Pavarësisht përmbushjes së plotë të detyrimeve procedurale nga ana e shkollës, lista e paraqitur është refuzuar me argumentin e vonesës së dorëzimit. Ky arsyetim nuk përputhet me të dhënat faktike, nuk mbështetet në prova dokumentare dhe përbën një interpretim të gabuar dhe formalisht të procedurës administrative. Theksojmë se i njëjti trajtim është aplikuar edhe ndaj listave të shkollave të tjera të qytetit të Korçës, çka tregon se problematika nuk lidhet me veprime apo mosveprime të veçuara të Shkollës “Nuçi Naçi”.*

*4. Mbi trajtimin e dokumentacionit të nxënësve N.M dhe E.M.*

*Dokumentacioni i paraqitur nga prindi i nxënësve është administruar në mënyrë të rregullt dhe është trajtuar në kuadër të së njëjtës procedurë të ndjekur për të gjithë nxënësit e tjerë, pa asnjë dallim, përjashtim apo trajtim preferencial. Përsa i përket pretendimit të prindit në prani të nxënësit E.M dhe punonjësit të shërbimit janë lexuar të gjitha shkresat, për arsye të analfabetizmit të znj. M.*

*5. Mbi pretendimin për diskriminim.*

*Mosdhënia e bursës nuk ka ardhur si pasojë e ndonjë veprimi diskriminues nga ana e shkollës, por si rezultat i një vendimmarrjeje administrative të mëvonshme, jashtë kompetencës së institucionit tonë.*

*6. Mbi kufijtë e kompetencës institucionale.*

*Shkolla ka përmbushur detyrimin e saj ligjor për evidentimin, verifikimin dhe përcjelljen e listave dhe dokumentacionit përkatës dhe nuk disponon kompetencë vendimmarrëse lidhur me miratimin apo refuzimin përfundimtar të bursave.*

*7. Dokumentacioni verifikues.*

*Bashkëlidhur Shkolla po dërgon të gjitha njoftimet e ardhura nga NSHMAÇ në shkollën tonë lidhur me bursat. Lexoni me vëmendje dhe do të kuptoni se pse dokumentet kanë filluar të mblidhen me vonesë. Gjithashtu kemi patur njoftim me mesazh nga znj. K.Z që të mos njoftohen prindërit pa dërguar email, sepse nuk kanë pasur një shkresë nga Ministria. Ka qenë email-i i datës 05.11.2025 nga znj. S.Z që kërkon të dorëzohen listat në po këtë datë. Shkolla jonë nuk është vonuar aspak dhe këto lista janë dërguar brenda kësaj date.*

*8. Nga znj. K.Z është dërguar mesazhi i mëposhtëm:*

*“Përshëndetje të gjithëve! Dua tu njoftoj se ka ardhur shkresa nga Ministria e Arsimit për planifikimin e numrit të bursave për vitin shkollor 2025-2026 dhe duhet që të gjitha shkollat të dorëzojnë dokumentacionin e mbledhur pranë ndërmarrjes ditën e enjte dhe të premtë pasi afati i fundit nga Ministria është caktuar dita e hënë datë 27.10.2025”.*

*Për sa më sipër këto dokumente të firmosura nga prindërit janë dorëzuar në datën 23.10.2025 (dite e enjte) pranë NSHMC dhe ishim ndër shkollat e para në dorëzim para afatit të përcaktuar.*

*Në këto kushte, Shkolla vlerëson se nuk mban përgjegjësi administrative apo ligjore për pasojat e krijuara nga refuzimi i listave të dorëzuara brenda afatit dhe mbetet në dispozicion të Komisionerit për çdo sqarim shtesë”.*

*Me shkresën nr. 846/1, datë 04.02.2026, Ministria e Arsimit në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “Ministria e Arsimit me shkresën nr. 471/1, datë 21.01.2026, të përcjellë pranë Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) Tiranë dhe Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) Korçë ka kërkuar informacion mbi ankesën e paraqitur.*

*ZVAP Korçë me shkresën nr. 61, datë 27.01.2026, protokolluar në Ministrinë e Arsimit me nr. 846, datë 29.01.2026, ka dërguar dokumentacionin e disponuar nga shkolla “Nuçi Naçi”.*

*Shkolla “Nuçi Naçi” me shkresën nr. 36, datë 22.01.2026 drejtuar Komisionerit (KMD) ka parashtruar argumentet dhe sqarime mbi procedurën e dhënies së bursave dhe konkretisht për ankesën me nr. 7, datë 06.01.2026 të z. A.M.*

*Në zbatim të pikës 8, të VKM nr. 666, datë 10.10.2019, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike”, i ndryshuar, njësitë e vetëqeverisjes vendore, bazuar në planin e përcaktuar sipas pikës 6, të këtij vendimi, me vendim të Këshillit Bashkiak, miratojnë dhënien e bursave, sipas kriterëve të përcaktuara në pikat 2.1, 2.2, 2.3 e 2.4, të këtij vendimi. Për pasojë, përzgjedhja e përfituesve sipas kriterëve të përcaktuara në këtë vendim, si dhe miratimi dhe alokimi i bursave është kompetencë e njësive të vetëqeverisjes vendore.*

*Ndërkohë, bëjmë me dije se me VKM nr. 812, datë 30.12.2025 “Për miratimin e Programit të Përgjithshëm Analitik të Projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2026” është parashikuar që Ministria e Arsimit do të propozojë për miratim pranë Këshillit të Ministrave projektvendimin “Për disa shtesa në VKM nr. 666, datë 10.10.2019, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike”, i ndryshuar”.*

Me shkresën nr. 8271/1, datë 09.01.2026<sup>2</sup> Ministria e Arsimit, ka kthyer përgjigje, duke sqaruar ndër të tjera se: “Në përgjigje të shkresës suaj nr. 1789/1, datë 22.12.2025. administruar pranë Ministrisë së Arsimit me nr. 8271, datë 23.12.2025 “Njoftim dhe kërkesë për informacion” dhe në zbatim të Vendimit nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar, Ministria e Arsimit, me qëllim që çdo nxënësi ti sigurohet e drejta për arsimim cilësor, si dhe shanse të barabarta për arsimimin e nxënësve që ndjekin arsimin me kohë të plotë në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar bën shpërndarjen e bursave për njësitë e vetëqeverisjes vendore pa përfshirë nxënësit që ndjekin arsimin profesional.

Sipas Vendimit nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar, pika 4, pika 5 dhe pika 30 citohet:

- 4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për uljen e nivelit të braktisjes shkollore, për nxënësit që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimimin, miratojnë bursa financiare me përfitues nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, pas konfirmimit nga mësuesi kujdestar dhe drejtori i shkollës për frekuentimin e procesit mësimor, si dhe nga zyra vendore e arsimit parauniversitar.
- 5. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për kategorinë e nxënësve që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimin bazë, dhe për uljen e braktisjes shkollore të arsimit bazë, mund të miratojnë dhe të shpërndajnë bursa edhe nga fondet e veta ose nga fondet buxhetore të përfituara në formën e transfertës së pakushtëzuar.
- 30. Ministria përgjegjëse për arsimin, për të gjitha kategoritë e nxënësve, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar, të parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi, pa përfshirë nxënësit që ndjekin shkollat profesionale, të japë 1 200 (një mijë e dyqind) bursa.

Gjithashtu, në zbatim të Vendimit nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar, pika 6, Ministria e Arsimit me anë të shkresës nr. 7094/1, datë 06.11.2025 “Dërgohet plani i bursave për nxënësit që ndjekin arsimin me kohë të plotë në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2025-2026”, ka bërë me dije Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore dhe Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar mbi planin e shpërndarjes së bursave.

Ndaj, duke zbatuar aktet ligjore në fuqi të cilësuar edhe më sipër, diferenca në numrin e bursave të kërkuara, mbi numrin e kuotave të miratuara nga Ministria e Arsimit, është kompetencë e Bashkisë Korçë”.

---

<sup>2</sup> Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 80, datë 12.01.2026.

2. Me shkresën nr. 129, datë 14.01.2026, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar informacion nga Ministria e Arsimit, lidhur me pretendimet e subjekteve ankues.
3. Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 387, datë 18.02.2026 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 05.03.2026, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Seanca dëgjimore u zhvilluar në datën 05.03.2026. Gjatë seancës dëgjimore të datës 05.03.2026, pala ankuese nuk mori pjesë, ndërsa palët e tjera, konkretisht Ministria e Arsimit dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, morën pjesë. Palët e pranishme, Ministria e Arsimit dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, i qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

Në përfundim të seancës, nga ana e Komisionerit iu kërkuar Ministrisë së Arsimit, për shkak të mosdërgimit të përgjigjeve të kërkuara me shkresat nr. 129, datë 14.01.2026, nr. 214/1, datë 02.02.2026 dhe nr. 173/1, datë 27.01.2026 të dërgojë pranë KMD-së informacionin e cituar në to.

4. Me shkresën 1025/1, datë 12.03.2026<sup>3</sup>, Ministria e Arsimit ka kthyer përgjigje Komisionerit, duke sqaruar ndër të tjera se:

*“Në zbatim të vendimit nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitim të bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, i ndryshuar, Ministria e Arsimit, me qëllim që çdo nxënës t’i sigurohet e drejta për arsimim në institucionet publike të arsimit parauniversitar, bën shpërndarjen e bursave për njësitë e vetëqeverisjes vendore, pa përfshirë nxënësit që ndjekin arsimin profesional.*

*Bazuar në vendimin e sipërcituar, Ministria e Arsimit miraton çdo vit kuotat e bursave në përputhje me fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit për këtë ministri, duke mbajtur në konsideratë numrin e përgjithshëm të nxënësve nga klasa 1-re deri në klasën e 12-të për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore, shpërndarjen e tyre gjeografike, numrin e bursave të miratuara në vitet e kaluara shkollore dhe fondin në dispozicion për mbështetje financiare të bursave për nxënësit që ndjekin arsimin me kohë të plotë në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, si dhe mbi bazën e të dhënave të raportuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet arsimore.*

---

<sup>3</sup> Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 129/1, datë 17.03.2026.

*Procesi i përcaktimit të kuotave realizohet mbi bazën e kriterëve objektive dhe të njëjta për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke synuar garantimin e një shpërndarjeje të balancuar të fondeve publike në nivel kombëtar dhe respektimin e kufijve buxhetorë të miratuar.*

*Në zbatim të pikës 8, të vendimit nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e lira të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike", i ndryshuar, njësitë e vetëqeverisjes vendore, bazuar në planin e përcaktuar sipas pikës 6 të këtij vendimi, me vendim të Këshillit Bashkiak, miratojnë dhënien e bursave, sipas kriterëve të përcaktuara në pikat 2.1, 2.2, 2.3 e 2.4 të këtij vendimi.*

*Për pasojë, përzgjedhja e përfituesve sipas kriterëve të përcaktuara në këtë vendim, si dhe miratimi dhe alokimi i bursave, është kompetencë e njësive të vetëqeverisjes vendore.*

*Referuar sa më sipër, Këshilli i Bashkisë Korçë me vendimin nr. 86, datë 29.08.2025, ka miratuar dokumentacionin dhe procedurën për përfitimin e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore parauniversitare.*

*Në shkronjat "h" dhe "i" të pikës 3 të këtij vendimi parashikohet se:*

*h) Në rast se numri i përfituesve, sipas listës së lartpërmendur, është më i lartë se numri i bursave të akorduara nga Ministria e Arsimit, do të përfitojnë bursë ata nxënës që kanë dorëzuar më parë aplikimin pranë shkollës.*

*i) Rast pas rasti, në varësi të buxhetit, Bashkia mund të mbështesë me bursa ata aplikantë të cilët nuk mbulohen nga fondi i miratuar nga Ministria e Arsimit, por që dokumentacioni i dorëzuar prej tyre është i rregullt dhe brenda afatit të dorëzimit.*

*Referuar faqes zyrtare të Bashkisë Korçë, rezulton se dorëzimi i dokumentacionit bëhet pranë sekretarive të shkollave, deri më datën 29 Tetor 2025.*

*Në vijim të këtij njoftimi, shkollat kanë dorëzuar dokumentacionin e plotë brenda afatit të shpallur, edhe për ata nxënës që nuk kanë përfituar bursa.*

*Lidhur me masat e marra, si dhe analizat afatmesme apo afatgjata të bëra nga Ministria e Arsimit në lidhje me ecurinë e kërkesave për bursa, sikurse kemi bërë me dije edhe me shkresa të mëparshme, ritheksojnë se me vendimin nr. 812, datë 30.12.2025 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Programit të Përgjithshëm Analitik të Projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2026", është parashikuar që Ministria e Arsimit do të propozojë për miratim pranë Këshillit të Ministrave projektvendimin "Për disa shtesa në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, 'Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte*

*dhe përcaktimin e kriterëve për përfitim të bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike', i ndryshuar”.*

*Ky projektvendim është propozuar për miratim me qëllim qartësimin mbi mënyrën e ndarjes së bursave sipas kuotave për nxënësit që plotësojnë kriteret, në zbatim të nenit 19 të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të pikës 2 të nenit 32 të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.*

*Miratimi i projektaktit synon të rregullojë çështjet që lidhen me qartësimin e mënyrës së përfitim të kuotave financiare për rastet kur numri i nxënësve që plotësojnë kriteret është më i lartë se numri i kuotave të miratuara.*

*Në zbatim të vendimit nr. 812, datë 30.12.2025 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Programit të Përgjithshëm Analitik të Projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2026”, Ministria e Arsimit ka miratuar urdhrin nr. 8, datë 13.1.2026, “Për ngritjen e grupeve të punës për hartimin e projektakteve në zbatim të programit të përgjithshëm analitik të projektakteve për vitin 2026”.*

*Grupi i punës është duke hartuar projektvendimin “Për disa shtesa në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave, 'Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitim të bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike', i ndryshuar”, i cili do t'i dërgohet për mendim edhe grupeve të interesit.*

*Në lidhje me rritjen e numrit të aplikimeve për bursa në disa njësi të vetëqeverisjes vendore, përfshirë Bashkinë Korçë, theksohet se dinamika e aplikimeve për bursa mund të ndryshojë nga një vit në tjetrin në varësi të faktorëve socialë dhe ekonomikë. Megjithatë, numri i bursave që mund të miratohet çdo vit është i kushtëzuar nga fondi buxhetor i miratuar për këtë qëllim dhe nga nevoja për të siguruar një shpërndarje të balancuar të këtij fondi në nivel kombëtar.*

*Lidhur me faktin se për vitin shkollor 2025-2026 është miratuar një numër më i ulët bursash krahasuar me vitet paraardhëse (2023-2024 dhe 2024-2025), sqarohet se përcaktimi i kuotave bëhet në funksion të fondit të miratuar në buxhetin e shtetit dhe në bazë të analizës së kërkesave të paraqitura nga të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore.*

*Në pikën 30 të vendimit nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, përcaktohet se: “Ministria përgjegjëse për arsimin, për të gjitha kategoritë e nxënësve, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar, të parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi, pa përfshirë nxënësit që ndjekin shkollat profesionale, jep jo më pak se 1200 (njëmijë e dyqind) bursa ...”.*

*Në zbatim të pikës 6 të VKM nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, Ministria përgjegjëse për arsimin, në fillim të çdo viti shkollor, në konsultim me institucionet*

*arsimore, harton planin e shpërndarjes së bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar, të cilin e dërgon në njësitet e vetëqeverisjes vendore jo më vonë se muaji tetor.*

*Për vitin shkollor 2023-2024, me anë të shkresës nr. 6470/52, datë 20.11.2023 e Ministrisë së Arsimit, me lëndë: “Dërgohet plani i numrit të bursave për nxënësit të cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2023-2024”, është dërguar numri i bursave të miratuara, 3804 në total, nga të cilat 350 për Bashkinë Korçë.*

*Vendimi nr. 666, datë 10.10.2019 i Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, sipas pikave 4 dhe 5 të tij, për uljen e nivelit të braktisjes shkollore, për nxënësit që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimimin, i njej të drejtën njësive të vetëqeverisjes vendore që të miratojnë bursa financiare shtesë me përfitues nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë. Bashkia Korçë për këtë vit shkollor ka miratuar 175 bursa.*

*Për vitin shkollor 2024-2025, nga Ministria e Arsimit janë miratuar 3818 në total. Për Bashkinë Korçë janë miratuar 350 bursa, dërguar me shkresën nr. 7228/37, datë 18.11.2024 e Ministrisë së Arsimit, me lëndë: “Dërgohet plani i numrit të bursave për nxënësit të cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2024-2025”.*

*Vendimi nr. 666, datë 10.10.2019 i Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, sipas pikave 4 dhe 5 të tij, për uljen e nivelit të braktisjes shkollore, për nxënësit që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimimin, i njej të drejtën njësive të vetëqeverisjes vendore që të miratojnë bursa financiare shtesë me përfitues nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë. Bashkia Korçë për këtë vit shkollor nuk ka miratuar bursa.*

*Për vitin shkollor 2025-2026, me anë të shkresës nr. 7094/1, datë 06.11.2025 e Ministrisë së Arsimit, me lëndë: “Dërgohet plani i numrit të bursave për nxënësit të cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2025-2026”, është dërguar numri i bursave të miratuara, 3871 në total, nga të cilat 280 janë miratuar për Bashkinë Korçë.*

*Vendimi nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, sipas pikave 4 dhe 5 të tij, për uljen e nivelit të braktisjes shkollore, për nxënësit që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimimin, i njej të drejtën njësive të vetëqeverisjes vendore që të miratojnë bursa financiare shtesë me përfitues nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë. Bashkia Korçë për këtë vit shkollor ka miratuar 40 bursa.*

*Sa më sipër, numri i bursave të miratuara nga Ministria e Arsimit në nivel kombëtar ka qenë në rritje. Për rrjedhojë, fakti që në një njësi të caktuar vendore numri i aplikimeve për bursa mund të tejkalojë kuotat e miratuara, nuk përbën në vetvete trajtim të pabarabartë apo diskriminues, për sa kohë që kriteret e përfitimit dhe procedurat e përzgjedhjes zbatohen në mënyrë të njëtrajtshme për të gjithë aplikuesit që ndodhen në kushte të njëjta faktike dhe ligjore.*

*Sa më sipër, në zbatim të pikës 8 të vendimit nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike", i ndryshuar, njësitë e vetëqeverisjes vendore, bazuar në planin e përcaktuar sipas pikës 6 të këtij vendimi, me vendim të Këshillit Bashkiak, miratojnë dhënien e bursave, sipas kritereve të përcaktuara në pikat 2.1, 2.2, 2.3 e 2.4 të këtij vendimi. Për pasojë, përzgjedhja e përfituesve sipas kritereve të përcaktuara në këtë vendim, si dhe miratimi dhe alokimi i bursave, është kompetencë e njësive të vetëqeverisjes vendore.*

*Gjithashtu, Vendimi nr. 666, datë 10.10.2019 I Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, sipas pikave 4 dhe 5 të tij, për uljen e nivelit të braktisjes shkollore, për nxënësit që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimimin, i njej të drejtën njësive të vetëqeverisjes vendore që të miratojnë bursa financiare shtesë me përfitues nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë”.*

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes**

#### **A. Lidhur me pretendimin e ankuesit kundër Drejtorit të Shkollës 9-vjeçare “Nuçi Naçi”**

Nga provat e administruara rezulton se dokumentacioni i aplikimit është dorëzuar nga prindi pranë shkollës “Nuçi Naçi”, Korçë, në datë 20.10.2025, sipas procesverbalit të firmosur nga të dyja palët. Shkolla me datë 23.10.2025, ka përcjellë listën me 29 aplikantë Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdheve (NSHMAC) për shqyrtim.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se ka shkuar për të dorëzuar dokumentet e aplikimit për përfitimin e bursës për fëmijët e tij, në datë 17.10.2025, dhe se nga ana e drejtorit të shkollës, është përdorur një gjuhë ofenduese dhe diskriminuese, rezulton se ky pretendim i ankuesit mbetet në nivel deklarativ dhe nuk mbështetet me prova të tjera objektive që të lejojnë Komisionerin të nxjerrë nga kjo rrethanë konkluzionin e trajtimit diskriminues.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Drejtorit të Shkollës 9-vjeçare “Nuçi Naçi”.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Drejtorit të Shkollës 9-vjeçare “Nuçi Naçi”, për shkaqet e pretenduara nga ankuesi dhe për rrjedhojë nuk provohet se Drejtori i Shkollës 9-vjeçare “Nuçi Naçi”, ka shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

#### **B. Lidhur me pretendimin e trajtimit të padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Bashkisë Korçë**

Subjekti ankues, z. A.M, është babai i dy fëmijëve (9 dhe 11 vjeç, nxënës në klasë të 3-të dhe të 5-të). Referuar Vërtetimit të datës 17.09.2025, të Drejtorisë së Kujdesit Social, të Bashkisë Korçë, vërtetohet se znj. D.M është përfutuese e pagesës së aftësisë së kufizuar. Ankuesi ka aplikuar për bursë për fëmijët e tij, E dhe N.M, nxënës në shkollën “Nuçi Naçi”, Korçë, për vitin shkollor 2025–2026, sipas kriterit joekonomik të përcaktuar në VKM nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, për nxënësit e arsimit parauniversitar që plotësojnë kriterin joekonomik.

Ndërkohë ankuesi ka aplikuar për të përfutuar këtë bursë, duke dorëzuar dokumentacionin e kërkuar pranë shkollës më datën 20.10.2025, por nxënësit nuk rezultuan përfutues për shkak se numri i bursave të akorduara nga Ministria e Arsimit ishte i kufizuar (280 bursa) dhe nga fondi i Bashkisë u akorduan vetëm 40 bursa të tjera, ndërkohë që numri i aplikimeve të rregullta ishte 542. Bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 86, datë 29.08.2025, përparësi u jepet aplikimeve të dorëzuara më parë, dhe kuotat u plotësuan me aplikimet e dorëzuara deri më datën 17.10.2025, duke lënë jashtë aplikimin e dorëzuar nga ankuesi më 20.10.2025. Për këtë arsye, fëmijët e ankuesit nuk ishin përfutues të bursës për vitin shkollor 2025–2026.

E drejta për arsim, është një e drejtë kushtetuese, e cila duhet të sigurohet mbi baza të barabarta dhe pa diskriminim. E drejta për arsim garantohet edhe në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat vendi ynë i ka ratifikuar duke u bërë kështu pjesë e sistemit të brendshëm ligjor dhe të detyrueshme për t’u zbatuar.

Kështu, në nenin 57 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikohet se:

1. *Kushdo ka të drejtën për arsimim.*
2. .... 3. .... 4. ....
5. *Arsimi i detyrueshëm, si dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm në shkollat publike është falas.*

Fëmija si çdo qenie njerëzore është bartës i të drejtave dhe si i tillë ka të drejtën për t’u arsimuar. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, e cila është ratifikuar nga vendi ynë, sanksionon të drejtën e fëmijës për t’u arsimuar mbi bazën e mundësive të barabarta.

Në nenin 28 të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës<sup>4</sup>, parashikohet se:

1. *Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për arsimim dhe, me qëllim që të arrihet kjo e drejtë, hap pas hapi dhe mbi bazën e mundësive të barabarta, në mënyrë të veçantë ata:*

- a) *Bëjnë arsimin fillor të detyrueshëm dhe falas për të gjithë;*
- e) *Marrin masa për të inkurajuar frekuentimin e rregullt të shkollës dhe uljen e përqindjes së braktisjes së shkollës.*

Neni 29

1. *Shtetet Palë u morën vesh që arsimimi i fëmijës të ketë për synim:*

---

<sup>4</sup> Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin 7531, datë 11.12.1991

*(a) Të zhvillojë potencialin e plotë të personalitetit, dhuntive dhe aftësive mendore e fizike të fëmijës;*

*(b) Të rrisë respektin për të drejtat e liritë themelore të njeriut dhe për parimet e mishëruara në Kartën e Kombeve të Bashkuara.*

Ligji 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i cili ka si qëllim garantimin e të drejtës kushtetuese për arsimim, sanksionon se, e drejta për arsimim garantohet pa u diskriminuar. Çdo nxënësi duhet t’i sigurohet e drejta për arsimim cilësor, si dhe shanse të barabarta për arsimim.

Kështu, në ligjin 69/2012, parashikohet se:

*Neni 5. E drejta për arsimim.*

- 1. Në Republikën e Shqipërisë garantohet e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, moshë, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar.*
- 2. Në shkollat publike arsimit të detyrueshëm dhe arsimit të mesëm të lartë janë falas.*

*Neni 6. Parime të përgjithshme.*

- 4. Në institucionet arsimore zbatohet parimi i gjithëpërfshirjes së nxënësve.*
- 5. Çdo nxënësi i sigurohet e drejta për arsimim cilësor, si dhe shanse të barabarta për arsimim.*
- 6. Nxënësve të familjeve në nevojë, nxënësve me aftësi të kufizuara dhe atyre me vështirësi në të nxënë u ofrohet përkujdesje e posaçme, sipas përcaktimeve në këtë ligj.*

*Neni 19. Përkujdesje për kategori të veçanta të nxënësve.*

*Kategorive të veçanta të nxënësve u sigurohet kujdes i posaçëm nga shteti. Format dhe kriteret e përkujdesjes përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.*

*Neni 28. Njësia bazë e qeverisjes vendore.*

- 1. Njësia e vetëqeverisjes vendore, mbështetur në propozimet e institucioneve arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe këshillat e mësuesve të institucioneve, sipas kriterëve të miratuara në këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore, mbështet: a) nxënësit e familjeve në nevojë; b) nxënësit me arritje të shkëlqyera; c) punonjësit e institucioneve arsimore për zhvillimin e tyre profesional dhe për zhvillimin e kurrikulës; ç) pajisjen e institucioneve arsimore me mjete mësimore; d) nxënësit me aftësi të kufizuara.*

Në zbatim dhe të legjislacionit të sipërcituar, Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për

*përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, e ndryshuar.*

Në pikën 2 të këtij vendimi përcaktohej se:

*2. Nxënësit, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë dhe arsimin e mesëm profesional në institucionet arsimore publike, përfitojnë bursë brenda kuotave dhe kritereve, si më poshtë vijon:*

*2.3 Kriteri joekonomik: .....*

*d) nxënësit, fëmijë të personit/personave që gëzojnë statusin e invalidit; .....*

*Në fillim të çdo viti shkollor, por jo më vonë se muaji nëntor i çdo viti, Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Mbrojtjes, Shërbimi Informativ i Shtetit dhe institucionet e përkujdesjes sociale rezidenciale publike, për këto kategori nxënësish, duhet të dërgojnë në institucionet arsimore ku ata ndjekin procesin mësimor si dhe në njësitë e vetëqeverisjes vendore përkatëse listën e nxënësve përfitues sipas pikës 2.3 të këtij vendimi.*

Qëllimi i përbashkët i akteve ligjore dhe nënligjore të sipërpërmendura është që nëpërmjet tyre të garantohet e drejta e fëmijës për arsim.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka konstatuar se nga ana e Bashkisë Korçë është pretenduar se shkak i mospërfitimit të bursës nga nxënësit ishte numri i kufizuar i kuotave të vëna në dispozicion nga Ministria e Arsimit dhe fondet e Bashkisë, i cili ishte më i vogël se numri i aplikantëve që plotësonin kriteret e përfitimit.

Komisioneri vlerëson se për sa kohë aplikuesit plotësonin të gjitha kriteret ligjore të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe i garanton atyre të drejtën për përfitimin e kësaj burse, pretendimi i institucioneve për mungesën e fondeve në dispozicion për të garantuar këtë të drejtë nuk mund të justifikohet dhe ngarkon institucionet me përgjegjësi.

Në VKM nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet publike”, i ndryshuar me VKM nr. 511, date 27.07.2022 pika 10 parashikohet se: “Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, njësitë e vetëqeverisjes vendore, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar, si dhe ofruesit e arsimit të mesëm profesional publik për zbatimin e këtij vendimi.

Sa më sipër, institucionet qendrore dhe ato vendore duhet të bashkëpunonin me njëra tjetrën për të bërë të mundur plotësimin e parashikimeve ligjore sa i takon çështjes objekt ankese, pasi kjo problematikë sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e Bashkisë Korçë ekziston dhe për një numër të konsiderueshëm aplikantësh të tjerë që plotësonin kriteret ligjore dhe që iu është mohuar kjo e drejtë.

Komisioneri konstaton që përveç Bashkisë Korçë dhe Ministria e Arsimit nuk ka ndërmarrë masa konkrete për zgjidhjen e kësaj situatë edhe pse Bashkia ia ka përcjellë këtë shqetësim.

Ministria e Arsimit është shprehur që duhet nga ana e Këshillit Bashkiak Korçë, të merren masa për zgjidhjen e këtij problemi, por referuar VKM-së Nr. 511, datë 27.7.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar, kjo është një bursë e cila ofrohet nga ana e Ministria e Arsimit.

Sipas pikës 30, në VKM nr. 666, datë 10.10.2019, ndryshuar me VKM nr. 511, datë 27.07.2022: “Ministria përgjegjëse për arsimin, për të gjitha kategoritë e nxënësve, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar, të parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi, pa përfshirë nxënësit që ndjekin shkollat profesionale, jep jo më pak se 1200 (një mijë e dyqind) bursa.”

Në zbatim të legjislacionit në fuqi, Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, i ndryshuar, rezulton se:

Në pikën 2 të këtij vendimi përcaktohet: 2.3 Kriteri joekonomik: d) nxënësit, fëmijë të personit/personave që gëzojnë statusin e invalidit;

Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes ka sqaruar se aplikimi është pranuar dhe shqyrtuar sipas procedurave ligjore, por nxënësit, E dhe N.M nuk kanë përfituar bursë për shkak të numrit të kufizuar të bursave. Për vitin shkollor 2025-2026, Ministria e Arsimit kishte akorduar 280 bursa për Bashkinë Korçë, ndërsa Bashkia kishte akorduar 40 të tjera, duke çuar totalin në 320 bursa. Numri i aplikimeve të rregullta brenda afatit ishte 542, prandaj kuotat u mbushën nga nxënësit që kishin dorëzuar dokumentacion deri më 17.10.2025, ndërsa aplikimi i z. M u dorëzua me datë 20.10.2025.

Komisioneri konstaton se, për sa kohë nxënësit E dhe N.M plotësonin të gjitha kriteret ligjore për përfitimin e bursës, ata kanë të drejtë të garantuar ligjërisht për përfitimin e kësaj burse. Duke qenë se kjo e drejtë është e parashikuar qartë në legjislacionin në fuqi, institucionet përgjegjëse, si Bashkia Korçë dhe Ministria e Arsimit, kanë detyrimin e drejtpërdrejtë dhe të detyrueshëm për të siguruar realizimin e saj. Çdo refuzim ose mospërfitim i saj, për shkak të kufizimit të kuotave ose arsyeve administrative, përbën një shkelje të të drejtave të fëmijës dhe detyrimeve ligjore të institucioneve, duke i ekspozuar nxënësit ndaj një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë.

Pra, Komisioneri vlerëson se refuzimi i bursës për E dhe N.M është i paarsyeshëm dhe bie ndesh me legjislacionin në fuqi, pasi ata plotësojnë kriterin joekonomik, ndërkohë që dokumentacioni i tyre ishte i plotë dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara.

Për sa më lart, Komisioneri arrin në përfundimin se, mospërfshirja e emrit të fëmijëve E dhe N.M në listën e përfituesve të bursës për vitin shkollor 2025-2026 nga ana e Bashkisë Korçë, i ka ekspozuar ata ndaj një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, duke ia mohuar të drejtën për të përfitur këtë bursë sipas kritereve joekonomike të pikës 2.3/d “*nxënësit, fëmijë të personit/personave që gëzojnë statusin e invalidit*” të Vendimit nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave, “*Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitim të bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike*”, i ndryshuar.

Gjithashtu, Komisioneri arrin në përfundimin se, për arsye se nga ana e Ministrisë së Arsimit nuk është ndërmarrë asnjë veprim për zgjidhjen e situatës jo vetëm për vitin shkollor 2025-2026, por edhe pasi është ngritur shqetësimi nga ana e Bashkisë Korçë për të njëjtën çështje, nxënësit E dhe N.M janë ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë nga MA, duke ia mohuar të drejtën për të përfitur këtë bursë sipas kritereve joekonomike të pikës 2.3/ç dhe 2.3/d të Vendimit nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave, “*Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitim të bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike*”, i ndryshuar.

### **C. Shkaku i mbrojtur**

Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (neni 18 (2)), askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), garanton të drejtën për të mos u diskriminuar bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë mbrojtjen nga diskriminimi për shkaqe si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

Ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, rregullon në mënyrë të drejtpërdrejtë zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit për shkak të *gjendjes familjare dhe përkatësisë prindërore*, të pretenduar nga pala ankuese si shkaqe diskriminuese, duke parashikuar në nenin 1, të tij se : “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.*”

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ky ligj

ka bërë në nenin 3, të tij, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit, garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme, që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura.

Në rastin në fjalë, pretendohet se nxënësit E dhe N.M, fëmijë të znj. D.M, janë diskriminuar për shkak të statusit joekonomik, duke i mohuar të drejtën e garantuar ligjërisht për përfitimin e bursës për nxënësit e arsimit parauniversitar, fëmijë të personit/personave që gëzojnë statusin e invalidit.

*Në parim*, në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese duhet të provojë në radhë të parë se shkakun e pretenduar prej saj është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit dhe në radhë të dytë duhet të provojë ekzistencën e tij.

Komisioneri vlerëson se “aftësia e kufizuar” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në LMD.

Sipas Vërtetimit të datës 17.09.2025, të Drejtorisë së Kujdesit Social, të Bashkisë Korçë, vërtetohet se znj. D.M është përfituese e pagesës së aftësisë së kufizuar.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, kategoria e nxënësve që gëzojnë statusin ligjor si fëmijë të personit që gëzojnë statusin e invalidit, është kategori që e mbart shkakun e mbrojtur.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pretendimi për diskriminim duhet të shqyrtohet bazuar në shkakun e *aftësisë së kufizuar*, pasi konsiderohet i provuar mbështetur në provat dhe faktet e administruara.

## **D. Lidhja e trajtimit të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur**

### **D.1 Lidhja e trajtimit të padrejtë e të pafavorshëm, me shkakun e aftësisë së kufizuar**

Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar, si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Neni 18, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku sanksionohet ky parim parashikon: *“1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive”*.

Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllorja për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund*

*të përlijet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë” (shih vendimet nr. 39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, të Gjykatës Kushtetuese).*

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara, ndërkohë që Protokollin 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminimi” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Në nenin 3, pika 1 të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, përcaktohet se: “*Diskriminim*” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të LMD, përcaktohet se: “*Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përlijtur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi*”.

Barra e provës në çështjet e diskriminimit është objekt i një rregullimi të posaçëm. Ky rregullim i posaçëm në lidhje me barrën e provës pasqyrohet në nenin 33, pika 7/1 të LMD-së ku sanksionohet se : “*7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim*”.

Një rregullim të posaçëm të barrës së provës për çështjet e diskriminimit parashikohet nga Kodi i Procedurave Administrative, në nenin 82, pika 2, të të cilit, përcaktohet si vijon: “*2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj*”.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni e ka zhvendosur barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se prima facie

është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, fillimisht duhet të krijohet një prezumim i diskriminimit (diskriminimi prima facie), barra më pas kalon tek pala e akuzuar, e cila duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njëren nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.<sup>5</sup>

Komisioneri çmon të nevojshme të theksoj se, është pikërisht bazuar në standardin e mësipërm të të provuarit, që do të shqyrtojë dhe do të konkludojë në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Në rastin konkret, gjatë hetimit administrativ të kësaj çështjeje dhe provave të vëna në dispozicion nga palët, rezultoi se pavarësisht ekzistencës së legjislacionit të aplikueshëm në bazë të të cilit fëmijët E dhe N.M, rezultojnë përfitues dhe faktit që:

- Nxënësit E dhe N.M plotësojnë kriterin joekonomik sipas pikës 2.3/d të VKM-së nr. 666/2019, si fëmijë të personit që gëzon statusin e invalidit.
- Për vitin shkollor 2025–2026, aplikimi i tyre u dorëzua brenda afatit të përcaktuar (20.10.2025).
- Aplikimi i nxënësve E dhe N.M për vitin 2025-2026 përmbushte dhe mbarte të gjitha informacionet dhe dokumentacionin e kërkuar nga administrata, duke përmbushur të gjitha kriteret ligjore dhe administrative të VKM-së nr. 666/2019 (pika 2.3/d)
- Për shkak të mungesës së fondeve të mjaftueshme dhe kuotave të limituara të vendosura nga Ministria e Arsimit dhe Bashkia Korçë, ata nuk kanë përfituar bursën për vitin shkollor 2025–2026.
- Kjo situatë e ka ekspozuar nxënësit ndaj një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, duke i mohuar të drejtën për të përfituar bursën sipas kriterëve ligjore.

Në analizë sa më sipër, Komisioneri vlerëson se jemi para situatës së prezumimit të diskriminimit të nxënësve E dhe N.M, në lidhje me mosdhënien e bursës për vitin shkollor 2025-2026, nga ana e Bashkisë Korçë dhe Ministrisë së Arsimit edhe pse plotësojnë kriteret sipas VKM-së nr. 666/2019 të ndryshuar, dhe si pasojë barra e provës bie mbi këtë subjekt.

---

<sup>5</sup> [https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra\\_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018\\_en.pdf](https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf), fq.232.

Në këto kushte, për të vërtetuar të kundërtën, Bashkia Korçë dhe Ministria e Arsimit duhet të përmbushnin dy kushtet e përmendura më sipër.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se:

- Sipas pikës 30 në VKM nr. 666, datë 10.10.2019, ndryshuar me VKM nr. 511, datë 27.07.2022: *“Ministria përgjegjëse për arsimin, për të gjitha kategoritë e nxënësve, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar, të parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi, pa përfshirë nxënësit që ndjekin shkollat profesionale, jep jo më pak se 1200 (një mijë e dyqind) bursa.”* Kjo parashikon një përgjegjësi të qartë ligjore të Ministrisë për ofrimin e bursave për nxënësit në pamundësi financiare.
- Bashkia Korçë, në zbatim të ligjit nr. 69/2012 dhe VKM nr. 666/2019, ka përgjegjësi të mbështesë nxënësit e familjeve në nevojë, duke administruar dhe ndihmuar në shpërndarjen e bursave në nivel lokal. Për vitin shkollor 2025–2026, Bashkia ka përcaktuar një kuotë prej 40 bursash, ndërkohë që për vitin 2024–2025 nuk ka dhënë asnjë bursë nga fondet e veta, duke lënë jashtë çdo mundësie aplikuesit lokalë.
- Nga shqyrtimi i trendit të aplikimeve dhe të dhënave të administruara, rezulton se numri i aplikimeve për bursa në vitet e fundit, ka qenë në rritje, por as Bashkia Korçë dhe as Ministria e Arsimit nuk kanë ndërmarrë masa për të rritur kuotat apo për të siguruar që të gjitha aplikimet që plotësojnë kriteret ligjore të marrin përfitimin. Kjo mungesë veprimi ka krijuar një situatë të përsëritur të trajtimit të padrejtë dhe të pabarabartë për nxënësit në nevojë dhe ata në kushtet e fëmijëve të ankueses.
- Nga ana e Ministrisë së Arsimit, nuk është ndërmarrë asnjë veprim për zgjidhjen e situatës jo vetëm për vitin mësimor 2025-2026, por edhe pasi është ngritur ky shqetësim nga ana e Bashkisë Korçë.
- Për rrjedhojë, mospërfshirja e aplikimit të nxënësve E dhe N.M, të cilët plotësojnë të gjitha kriteret joekonomike për përfitimin e bursës, tregon një trajtim të padrejtë dhe të pabarabartë, duke shkelur të drejtën kushtetuese për arsimim dhe detyrimet ligjore të institucioneve përgjegjëse për garantimin e barazisë në aksesin në bursat për nxënësit në nevojë dhe atyre në kushtet e fëmijëve të ankueses.

Komisioneri vlerëson se, qëllimi i VKM-së nr. 666/2019, të ndryshuar, është ndër të tjera të mbështesë financiarisht, kategori përfituese të veçantë, si: familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike; nxënësit, fëmijë të personit/personave që gëzojnë statusin e invalidit apo fëmijë me aftësi të kufizuara, në mënyrë që këtyre fëmijëve tu garantohet e drejta për arsimim.

E drejta për arsim, është një e drejtë themelore e njeriut, e sanksionuar në nenin 57 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Shteti ka detyrimin që jo vetëm ta parashikojë, por edhe ta përmbushë këtë të drejtë duke e garantuar atë. Detyrimi për të përmbushur do të thotë që shteti duhet të marrë masa pozitive për të siguruar dhe lehtësuar gëzimin e të drejtave, sidomos për grupet shoqërore më të pamundura, të cilat në të kundërt, nuk do të kenë mundësi të kenë qasje në regjistrimin apo ndjekjen e arsimit.

Fëmija si çdo qenie njerëzore është bartës i të drejtave dhe si i tillë ka të drejtën për t'u arsimuar. Konventa Mbi të Drejtat e Fëmijës, e cila është ratifikuar nga vendi ynë, sanksionon të drejtën e fëmijës për t'u arsimuar mbi bazën e mundësive të barabarta dhe shtetet palë duhet të marrin masa për të inkurajuar frekuentimin e rregullt të shkollës dhe uljen e përqindjes së braktisjes së shkollës.

Ligji 69/2012 *“Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”*, i cili ka si qëllim garantimin e të drejtës kushtetuese për arsimim, sanksionon se, e drejta për arsimim garantohet pa u diskriminuar. Çdo nxënës duhet t'i sigurohet e drejta për arsimim cilësor, si dhe shanse të barabarta për arsimim.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, Bashkia Korçë dhe Ministria e Arsimit për të garantuar të drejtën për arsim të të gjithë fëmijëve, të cilët plotësonin kriteret respektive të parashikuara në VKM duhet të kishte parashikuar trajtimin me bursë të të gjithë fëmijëve që i plotësonin kushtet për përfitimin e saj.

Pra sa më sipër, fëmijët e ankuesit, z. A.M, janë vënë në pozita diskriminuese, për shkak të aftësisë së kufizuar të nënës së tyre.

Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026<sup>6</sup>, ka si vizion të saj: *“Sistem arsimor gjithëpërfshirës dhe i bazuar në parimet e barazisë dhe mësimi gjatë gjithë jetës, që mundëson formimin cilësor të të gjithë individëve, duke kontribuar në mirëqenien personale të tyre, si dhe në forcimin e demokracisë dhe integritetin e vendit në Bashkimin Evropian”*.

Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026, ndër objektivat e saj specifik ka parashikuar dhe objektivin specifik A.2, ku citohet: *“Sigurimi i mirëqenies sociale, emocionale dhe fizike të të gjithë nxënësve për të ulur braktisjen dhe për t'u mundësuar nxënësve të arrijnë potencialin e tyre të plotë;...”*

Një dokument tjetër dokument strategjik i miratuar nga qeveria shqiptare me VKM-në Nr. 152, datë 13.03.2024, është dhe Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2024-2030. Kjo strategji synon: *“... të përmirësojë mirëqenien fizike, shoqërore dhe ekonomike të individëve, fëmijëve dhe familjeve, veçanërisht të atyre në kushte sociale ose ekonomikisht të pafavorizuara, duke garantuar shanse të barabarta dhe parimet e drejtësisë sociale. Strategjia synon reduktimin e varfërisë, sidomos varfërisë ekstreme, duke garantuar një jetesë dinjitoze për familjet/individin dhe fëmijët. Varfëria do të ulet, duke nxitur zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive të tyre nëpërmjet adresimit të nevojave në kontekstin e rehabilitimit, integritetin në tregun e punës dhe të shërbimeve shoqërore... Paketa mbështetëse me subvencione shtesë/bonuse për vaksinimin dhe arsimimin e fëmijëve, si dhe ofrimi i paketës së ndihmës në natyrë tregon vëmendjen e shtuar për të asistuar familjen në tërësi duke integruar të gjitha llojet e shërbimeve publike...”*<sup>7</sup>.

Në rastin konkret, gjatë hetimit administrativ të kësaj çështje dhe provave të vëna në dispozicion nga palët, rezultoi se, pavarësisht ekzistencës së legjislacionit të aplikueshëm dhe faktit që nxënësit

<sup>6</sup> Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 621, datë 22.10.2021.

<sup>7</sup> Objektivat e Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024-2030.

i sigurohet e drejta për arsimim cilësor dhe mundësi të barabarta, nxënësit e familjeve në nevojë dhe atyre me vështirësi u ofrohet kujdes i veçantë nga shteti, duke përfutuar lehtësira në ushqim, mensa, bursa financiare, rezultoi që nxënësit E dhe N.M, fëmijë të subjektit ankues, nuk kanë përfutuar këtë bursë, e cila u njihet sipas akteve në fuqi.

Megjithatë, duke mbajtur në konsideratë detyrimin dhe përgjegjësitë e shtetit për të vënë në dispozicion fonde publike për të garantuar aksesin në arsim, sipas meritës, pavarësisht nga mundësitë financiare të individëve, Komisioneri thekson se, vendosja e një sistemi të përshtatshëm bursash, përbën një nga mjetet për të siguruar realizimin e plotë dhe në baza të barabarta për të gjithë të të drejtës për arsim.

Bashkia Korçë, për vitin shkollor 2025–2026, ka dështuar të mbulojë me fonde të veta nxënësit që plotësonin kriteret për bursë por nuk rezultuan përfutues për shkak të mungesës së kuotave nga Ministria e Arsimit, duke akorduar vetëm 40 kuota shtesë, pavarësisht rritjes së vazhdueshme të numrit të aplikantëve. Ky mosveprim përbën një shkelje të detyrimeve të pushtetit vendor ndaj familjeve në nevojë, duke pasur parasysh se Bashkia disponon instrumente ligjore dhe administrative për mbështetje sociale, dhe kjo problematikë e përsëritur ka qenë objekt rekomandimesh të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të cilat deri më sot nuk janë reflektuar me masa konkrete nga institucionet përgjegjëse.

Bazuar në tërësinë e fakteve dhe provave të administruara në lidhje me rastin konkret të z. A.M, Komisioneri vlerëson se Bashkia Korçë dhe Ministria e Arsimit nuk arritën të provojnë dhe të jepnin një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, lidhur me trajtimin e padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë të cilit i janë nënshtruar nxënësit E dhe N.M.

Sa më sipër, rezulton plotësisht e provuar lidhja shkakësore midis shkakut të mbrojtur, që në rastin konkret është aftësia e kufizuar, e nënës së nxënësve si person me aftësi të kufizuara, dhe trajtimin të pafavorshëm dhe të pabarabartë, të cilit i janë nënshtruar nxënësit E dhe N.M.

Komisioneri arrin në përfundimin se, mospërfutimi i bursës për vitin shkollor 2025-2026 të fëmijëve E dhe N.M, si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të Bashkisë Korçë dhe Ministrisë së Arsimit, i kanë ekspozuar ata ndaj një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, duke iu mohuar e drejta për të përfutuar këtë bursë sipas kriterit 2.3/d “nxënësit, fëmijë të personit/personave që gëzojnë statusin e invalidit” të Vendimit nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfutimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, i ndryshuar”, për shkakun e diskriminimit të pretenduar.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”, ndërsa në nenin 33, pika 12, përcaktohet se : “Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”.

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 33/10, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktima të diskriminimit. Ky ligj, nëpërmjet nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese është marrja e masave nga ana e institucioneve përgjegjëse, që të sigurojnë dhënien e tarifës së bursës së mohuar për vitin shkollor 2025-2026.

Komisioneri vlerëson se Bashkia Korçë dhe Ministria e Arsimit duhet të kenë në konsideratë këto kategori nxënësish, të cilët, për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike dhe faktit që fëmijët janë përfitues për shkak të të qenit fëmijë të një prindi me aftësi të kufizuara, ndodhen në kushte më vulnerabël, me qëllim garantimin, njësoj si për të gjithë nxënësit e tjerë, të së drejtës për arsimim dhe barazi në përfitimin e mbështetjes financiare.

Gjithashtu, Komisioneri vlerëson se Ministria e Arsimit duhet të marrë masa konkrete për të bashkëpunuar, koordinuar dhe konsultuar me njësitë e vetëqeverisjes vendore gjatë procesit të përcaktimit të kuotave, duke i përshtatur ato në mënyrë proporcionale me nevojat reale të bashkive. Ky proces është i domosdoshëm për të mundësuar vlerësimin dhe adresimin efektiv të problematikave të evidentuara, me qëllim shmangien e situatave të tilla në të ardhmen dhe garantimin e barazisë në aksesin ndaj përfitimeve, duke parandaluar sjellje me efekt diskriminues.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenet 32 dhe 33, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Konstatimin e diskriminimit të nxënësve E dhe N.M<sup>8</sup>, nga ana e Bashkisë Korçë dhe Ministrisë e Arsimit për shkak të *aftësisë së kufizuar*.
2. Konstatimin e mosdiskriminimit të nxënësve E dhe N.M, nga ana e Drejtorit të Shkollës 9-vjeçare “Nuçi Naçi”, Korçë, për shkak të aftësisë së kufizuar.
3. Në zbatim të pikës 1, Bashkia Korçë dhe Ministria e Arsimit, të marrin masa, për sigurimin e fondeve të nevojshme dhe dhënien e tarifës së bursës për vitin 2025-2026 sipas kriterit të parashikuar në VKM-në nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar, për nxënësit E dhe N.M.

---

<sup>8</sup> Përfaqësuar në këtë ankesë nga babai i tyre z. A.M.

4. Ministria e Arsimit dhe Bashkia Korçë, të marrin masa konkrete për sigurimin e numrit të kuotave të nevojshme për dhënien e bursave, për të gjitha kategoritë përfituese, sipas VKM-në nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar.
5. Për të shmangur situatën e krijuar në rastin konkret, rekomandohet Bashkia Korçë dhe Ministria e Arsimit, të marrin masa, për një bashkëpunim më intensiv dhe të frytshëm, për koordinimin dhe konsultimin mes pushtetit vendor dhe atij qendror, gjatë procesit të hartimit kuotave në proporcion me nevojat e bashkisë.
6. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani për këtë vendim, Bashkia Korçë dhe Ministria e Arsimit, të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat konkrete të marra për zbatimin e këtij vendimi.
7. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
8. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONER**

**Genta Tafa (BUNGO)**